

**AKT THEMELIMI**  
**I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**

**ELINA TURIZEM**

Sot, më date 17.10.2024, personalisht:

Orhan Aslantürk, atësia Bayram, amësia Fatma, shtetas Turk, lindur në Adana, Kemer dhe banues në Antalya, Turqi, lindur më 20/11/1981, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me cilesine e ortakut themelues te shoqerise tregtare **ELINA TURIZEM**

Përpilon këtë akt themelimi të shoqërisë tregtare me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

Të themelojë Shoqërinë Tregtare **ELINA TURIZEM SH.P. K.** në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri **ELINA TURIZEM SH.P. K.** sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

**NENI 2 Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.**

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë thellësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

**NENI 3 Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit **ELINA TURIZEM SH.P.K** dhe ajo do të ketë edhe vulën e saj.

**NENI 4 Objekti i veprimtarisë**

Shoqëria, në përputhje me dispozitat dhe kufizimet e ligjit, ka për objekt veprimtaritë e mëposhtme:

- Dhënien me qira dhe huadhënien operacionale të automjeteve pa shofer dhe transporte të tjerë rrugor të pasagjerëve si shërbime charter, ekskursione dhe transporte të tjerë të rastit me autobus, dhënies me qira të veturave private me shofer etj.



- Tregtia e veturave dhe automjeteve me fuqi motorike të vogël dhe tregtia me shumicë dhe pakice e pjesëve dhe aksesorëve të automjeteve dhe motorçikletave.
- Aktivitete të ndërmjetësimit për shitjen e një varieteti mallrash.

#### **NENI 5 Selia e Shoqërisë dhe Afati**

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Rr. Myrtezim Kellici, PL.Al-FAM, Nr.29, Tiranë.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhe kohore pa afat.

#### **NENI 6 Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar eshte 100.000 (njqind mije) Lek dhe zotërohet nga ortaku themelues.

Vlera totale e kapitalit te regjistruar: 100.000 leke

Vlera e paguar: 100.000 leke

Numri total i kuotave: 1

Kapitali themeltar eshte mbuluar tërësisht nga ortaku i vetem themelues.

#### **NENI 7**

Ortaku themelues i Shoqërisë Tregtare **ELINA TURIZEM SH.P.K** zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

- Orhan Aslantürk, pjesemarrja me perqindje 100 %, 1 kuote, lloji i kontributit ne para 100.000 leke.

Kapitali themeltar eshte mbuluar tërësisht nga ortaku i vetem themelues.

#### **NENI 8 Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Ortaku i Vetem – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

#### **NENI 9 Administratori**

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit i cili zgjidhet për një mandat 5 (pese) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administatori i parë te shoqërisë do të jenë Z. Orhan Aslantürk, nga data 17.10.2024 deri me 17.10.2029.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

#### **NENI 10**

Ortaku mund të vendose me vullnetin e tij, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

#### **NENI 11**

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

#### **NENI 12**

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

#### **NENI 13**

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaku Themelues u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimi hartohet në gjuhën shqipe pasi ortaku është njohës i gjuhës shqipe.

### **ORTAKU I VETEM THEMELUES**

**Orhan Aslantürk**

*Orhan Aslantürk*

